

ÉRIC-EMMANUEL SCHMITT

HAKMARRJA E FALJES

TREGIME

BOTIMET TOENA

ÉRIC-EMMANUEL SCHMITT

i akademisë “Goncourt”

HAKMARRJA E FALJES

tregime

Përktheu nga origjinali frëngjisht
Blerta Hyska

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2022

Autori: Éric-Emmanuel Schmitt (Erik-Emanyel Shmit)
Titulli në origjinal: La vengeance du pardon
Botoi në frëngjisht: Albin Michel



Me bashkëfinancimin e Programit
“Europa Krijuese” të Komisionit European.

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo
Redaktore: Besa Vila
Korrektore letrare: Majlinda Bami
Përkujdesja grafike: Edona Marku
© e imazhit në kopertinë: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-348-66-1

© Éditions Albin Michel - Paris 2017
© *në shqip* Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. “M. Gjollësja”, K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

www.toena.al

MOTRAT BARBARINI

Nëse do ta imagjinonim parajsën tokësore në formën e një fshati, do të ishte Shën-Sorlën.

Përgjatë rrugëve me kalldrëm, që zbrisnin shpatin e butë deri te lumi, secila fasadë formonte një kopsht. Lulevilet varnin fenerët e tyre lejla në ballkone, barbarozat flakëronin në dritare, hardhitë ndriçonin katet përdhese, luletogëzat shpërthenin pas stolave, ndërsa degëzat e zambakut të luginës nxirrnin kokën midis gurëve, duke kompensuar shtatin e tyre të vogël me një aromë të fuqishme.

Kujtdo që kalonte andej, Shën-Sorlëni i linte kujtimin e të pasurit vetëm një stinë: muajin maj. Lule kishte me bollëk atje, të gjalla, të kolme, të paturp, duke i shndërruar shtëpitë në mbajtëse lulesh. Nën një qiell blu dhe naiv, një aleancë mes trëndafilash pushtonte muret, trëndafila rozë, të kolmë, të lulëzuar, më të pjekur se frutat e pjekura, të gjallë, të begatë, duke shfaqur një mish petalesh që ndillnin përkëdhelje ose puthje, trëndafila të zinj, të turpshëm dhe të përflakur, trëndafila të kuq, të thatë dhe të hollë, trëndafila të verdhë me aromë piperi të imët, trëndafila portokalli,

të heshtur, pa aromë, trëndafila të bardhë, të befasuar, të përkohshëm, shumë shpejt të zhgënjyer, të oksiduar tashmë.

Aty-këtu, ashtu si barbarët që vijnë zaptojnë qytetin, trëndafila të egër, të imët, me gjethe të puçëruara, nxirrnin kokrra të kuqërremta, nga të cilat banorët bënëin reçel. Përreth sofatit të govatës, ortencat e dendura me ngjyrë të purpurt i jepnin vendit një pamje borgjeze të respektueshme. Nga kisha Shën Maria Madelenë deri në brigjet e Ronit, bimësia shpërthente në Shën Sorlën.

Nëpër “Place de la Halle” ecte Lili Barbarin, një zonjë e moshuar, sharmi i së cilës ndërthurej me rrugicat lozonjare. E buzëqeshur, shtathollë, çehre delikate, hundë e hequr, sy të çelur, ajo ishte mishërimi i mirësisë. Nëse Shën-Sorlën do të ishte parajsa, Lili sigurisht mishëronte gjyshen ideale! Dashamirëse, e shqetësuar për të ndihmuar bashkëqytetarët e saj, ajo e përjetonte pleqërinë zvetënim të butë, të përzier me altruizmin. Megjithatë jeta duhej ta kishte çuar drejt urrejtjes, mbushur me inat. A nuk ishte sulmuar ajo për dekada? A nuk ishte përçmuar, abuzuar, tradhtuar, urreyer? Dhe, mbi të gjitha, a nuk do të dilte ajo të nesërmen para gjykatës për vrasje?

Ashtu si qyteti me pamje idilike, që strehonte hisen e tij të inatit, xhelozisë dhe krimin, po ashtu nën maskën e saj të lëmuar dhe të freskët, zonja e moshuar kishte cikur ferrin. A i kishte kapërcyer dyert e tij? A e kishte kryer ajo të pafalshmen?

Akuzuesi i saj, Fabien Gerbieri, e vëzhgonte nga punishtja e tij e këpucarisë. Madhosh, i gjatë, vetullën

ngritur, syrin e zi, ai rrihte shuaj me çekan me një forcë që i drejtohej Lili Barbarinit. Pavarësisht nga mosha e zonjës, brishtësia e saj dhe prezumimi i pafajësisë, ai e konsideronte të patolerueshme që ajo të mbetej e lirë dhe të bënte për vete bashkëqytetarët e saj. Ishte ai që kishte ngritur dyshimet, ai që kishte motivuar xhandarët, kishte ngritur në këmbë policinë, kishte bërë të fillonte procedura gjyqësore, ishte ai përgjegjësi për byzylykun elektronik që i shtrëngonte kyçin e këmbës, autoritetet zemërbuta nuk dëshironin ta arrestonin para zhvillimit të seancës.

Nesër, Fabien Gerbieri do të shkonte në gjykatë në Burg-on-Bres. Nesër ai do të merrte pjesë në spektaklin e drejtësisë në veprim. Nesër, më në fund, do të merrej vesh.

Për javë të tëra, në tryezë, banorëve të Shën-Sorlënit u pëlqente t'u tregonin të huajve ose miqve që kalonin andej historinë e Lili Barbarinit. Ose më saktë historinë e motrave Barbarin, sepse, megjithëse vetëm njëra ishte ende gjallë, nuk mund të flitej për njërin pa përmendur tjetrën.

*

- E pabesueshme!

Motrat Barbarin panë dritën në të njëjtën ditë. Nëse e para ngjalli admirim, e dyta ngjalli hutim duke u shfaqur mes kofshëve të rraskapitura të nënës së saj gjysmë ore më vonë. Askush nuk e kishte parashikuar atë. Në një kohë

kur mjekët nuk e kontrollonin dot me ultratinguj barkun e pacienteve të tyre, lindja zbulonte seksin dhe numrin e fëmijëve.

- Dy, zonja Barbarin! Këtë po na përgatisnit në fshehtësi: dy vajza të bukura!

Mamia ngazëllente.

Njësoj të madhërishtme, të ngjashme që nga sytë e tyre kaltërosh e deri te palat e gishtërinjve, motrat Barbarin i mbushën prindërit me krenari. Ishte e jashtëzakonshme të bëje një foshnjë, por dy, dy krejtësisht identike, ishte një mrekulli!

- Çfarë mrekullish!

Të mahnitur, të rriturit e pranishëm nuk u morën fare me furinë me të cilën kishte dalë e dyta, as me klithmën e indinjatës që ajo kishte lëshuar, sikur të ishte inatosur me njerëzit që as nuk e kishin pikasur, as nuk e kishin pritur.

- Si do t'i quani?

Pa ngurrim, Barbarinët pagëzuan më të madhen prej tridhjetë minutash, “Lili”, sikurse e kishin parashikuar. Për më të voglën, ata u gjendën ngushtë për një moment. Si përfundim, vendosën për “Moiseta” pasi, nëse do të kishin bërë një djalë, do ta quanin “Moisi”.

Lili dhe Moiset... Ata që u mahnitën nga çrregullsia e rrokjeve, emri i parë tingëllonte këndshëm, i dyti i çuditshëm, nuk e kishin gabim të shqetësosheshin. Një emër nga halli nuk ndjell asgjë të mirë...

Lili dhe Moiseta jetuan të lumtura për katër vjet. Familja Barbarini i gëzohej binjakësisë spektakolare të tyre dhe, për argëtim, e nxirrte më tepër në pah atë: vajzat e vogla nuk ndaheshin kurrë, visheshin njëlloj, i quanin “binjaket”.

Para se të praktikonin gjuhën e shoqërisë, Lili dhe Moiseta folën idiomën e tyre, një gumëzhitje të rrjedhshme, të artikuluar që kalonte nga njëra te tjetra pa ndërprerje, një përzjerje belbëzimesh dhe cicërimash, aq e qartë për to, sa edhe e pakuptueshme për të tjerët rreth tyre.

- Sa mirë që merren vesh! - habiteshin shpesh fqinjët, të cilët i vëzhgonin se si zvarriteshin, luanin, hanin, flinin, vraponin, recitonin dyshe.

Në të vërtetë, po t'i vëzhgoje mirë, ato nuk “merreshin vesh” në kuptimin e zakonshëm të fjalës, sepse të merresh vesh - të shprehesh, të dëgjosh, të përgjigjesh - duhen dy. Lili dhe Moiseta po rriteshin krah për krah, pa ndier se ishin ndryshe. Me sa dukej, në agun e jetës së tyre, motrat nuk e dinin se ishin dy, ato formonin një person të vetëm, entitet me dy trupa, një organizëm me katër krahë, katër këmbë, katër buzë dhe dy gojë. Kur njëra fillonte një gjest, tjetra e përfundonte. Sikur një placentë e padukshme t'i bashkonte ende, ato pluskonin në harmoni, të ruajtura nga një xhep mbrojtës, një fluskë e mbushur me lëng amniotik ku lëviznin qetësisht, në temperaturë konstante, duke vibruar në rezonancë me njëra-tjetrën.

Cila ngjarje e shpoi këtë xhep? Çfarë thike i zgjidhi të dyja motrat?

Atë mëngjes, për katërvjetorin e tyre, prindërit Barbarin vendosën një pako blu në duart e Lilit, një pako të kuqe në duart e Moisetës. Të ngazëllyera, secila nga vajzat e vogla e shikonte dhuratën e saj me ëndje, pastaj u përkulën duke buzëqeshur për të parë atë të motrës. Moisetë lëshoi të kuqen dhe kapi blunë, që e tërhiqte më shumë, gjë që Lili e pranoi. Prindërit ndërhyrën:

- Jo! Bluja është e Lilit, e kuqja për Moisetën.

Ata i ndanë përsëri dhuratat. Katër sekonda më vonë, Moisetë kokëfortë filloi përsëri.

- Moisetë, nuk e kupton: e jotja është e kuqe, jo blu.

Moisetë vrenjti vetullat. Ajo preferonte ngjyrën blu më shumë sesa ngjyrën e kuqe dhe nuk e kuptonte pse ia largonin atë pako. Ajo e kapi.

Një goditje e lehtë në dorë e ndaloi. E bezdisur, ajo mbeti gojëhapur.

- Jepini, hapni dhuratat tuaja, vajza!

Ndërsa Moisetë shikonte, Lili zhveshi mbështjellësen e kaltër dhe zbuloi një kuti me një kukull brenda.

- Oh! - thanë njëzëri vogëlushet.

Ashtu si motra e madhe, Moisetë po ngazëllehej para krijesës magjepsëse bionde, e veshur me atllas të bardhë, e ulur në kuti.

- Ajo është e bukur! - pëshpëriti Lili.

- Oh, po! - miratoi Moisetë.

Lili ngriti butësisht plastikën, nxori kukullën dhe e vendosi atë në këmbë. Moisetë shikonte gjithë vëmendje skenën, a thua ishte pjesë e saj.

Pastaj Lili përkëdheli flokët e artë të kukullës, gjest që Moisetë e inkurajoi. Më në fund, Lili puthi faqet e saj rozë, faqet e Moisetës u përflakën sikur të ishin puthur edhe ato.

- Moisetë, po dhurata jote?

Moisetës iu deshën dhjetë sekonda për të kuptuar që prindërit e saj po flisnin me të. Ata këmbëngulën:

- Nuk je kureshtare?

- Më pëlqen kukulla.

- Ke të drejtë: ajo është shumë e bukur.

- Më pëlqen.

- Po, por është e Lilit.

Duke mos përfillur vërejtjen, Moisetë zgjati dorën që Lili t'ia jepte kukullën asaj.

Prindërit vendosën të ndërhyjnë.

- Jo, Moisetë, është kukulla e Lilit!

Ata i rrëmbyen lodrën që ajo kishte shtrënguar në gjoksin e saj dhe ia kthyen me forcë Lilit.

- Është e jotja: ruaje!

Moisetë u mendua dhe, disa sekonda më vonë, shtriu dorën drejt Lilit që ia ktheu kukullën. Prindërit ndërhyjnë. Dhuna po përgatitej të shpërthente.

- Jo, mjaft tani! Nuk do t'i ngatërroni më. Lëre dhuratën e Lilit. Shpaketo tënden.

Në formë refleksi ndaj tonit kërcënues, Moiseta filloi të qante.

- Sa budallaqe! Merr një dhuratë dhe as nuk ia hedh sytë. Edhe ne pse lodhemi kaq shumë...

Moiseta nuk kuptonte asgjë, përveç se ajo nuk kishte më të drejtë të vepronte siç dëshironte. Lili vrapoi për ta përqaftuar dhe u ngashërye dhe ajo, ishte ngjitëse. E qetësuar, Moiseta derdhi edhe disa lot, pastaj shqyrtoi situatën: nëna me kokëfortësi po i tregonte pakon e kuqe.

Me pahir dhe me fytyrë të vendosur, Moiseta grisi letrën dhe nxori një ari të mrekullueshëm.

- Oh, sa i bukur është ky ari! - bërtitën prindërit për ta stimuluar.

Moseta i kushtoi vëmendje e inatosur.

- A të pëlqen?

Duke u kthyer nga e motra, e cila po shikonte arushin me ëndje, ajo pëshpëriti:

- Po!

Duke e konsideruar veten të larë, ajo kapi kukullën.

Sherri degjeneroi. Të irrituar, prindërit ngritën zërin, Moiseta filloi të qante përsëri dhe, në shenjë solidariteti, Lili ulëriu.

- Oh, jo, jo, mos fillo edhe ti, Lili! Mos e inkurajo edhe ti tani! Mos u bëj aq budallaqe sa Moiseta!

Shpërthyen të sharat, kërciti dera, prindërit u larguan, duke i lënë vajzat e vogla të ngashëryera në dysheme, në mes të letrave të paketimit.

Kjo ditëlindje kishte gërvishtur njëjtësinë e binjakeve: secila e kishte kuptuar turbullt që nuk ngatërrohej me tjetrën. Në moshën katërvjeçare, ato kishin lindur përsëri, por dy këtë herë. Të dallueshme. Lili dhe Moisetë.

Për Lilin, ky ishte informacion; për Moisetën, ishte zi. Ajo jo vetëm nuk ishte e motra, por ishte e vetme. Për më tepër, e trajtonin më keq. Secili nga ne është shastisur gjatë fëmijërisë: papritur kemi perceptuar hapësirën mes nesh dhe pjesës tjetër të botës, kemi kuptuar se ekzistonim mënjanë, të ndryshëm, trupa të veçantë në mes të trupave të huaj, rrethorë mendorë të vetëm. Padrejtësi e ndërgjegjes... Për disa fëmijëria është magji, për disa të tjerë është rrënim. Për të parët, ngrihet një perde mbi botën, për të dytët një mur i mbyll në një burg. Vetmia është një mbretëri të cilës disa i shohin fronin, disa i shohin kufijtë.

Lili ndjeu gëzim teksa zbulonte natyrën rreth saj; për më tepër, ajo lëvizte e pajisur me një binjake! E fyer, mosbesuese, Moisetë e konsideroi universin jo mikpritës dhe vuri re që prania e së motrës i hiqte ndikimin, përmasën, sundimin e saj... Gjatë këtij përvjetori të katërt, Lili kishte fituar një motër, Moisetë kishte gjetur një rivale.

Duke filluar nga ajo ditë, binjaket mbetën një në sytë e fshatit, por jo më në sytë e tyre.

Prej refleksit, në çdo rrethanë, përballë prindërve, mësuesve, shokëve, ato bëheshin një. Nëse nëna e tyre

shkelte mbi një llambë të thyer kur kthehej në shtëpi, të dy vajzat mblidheshin: “Nuk e bëra unë!”, bërtiste Lili. “Nuk e bëra unë!”, shtonte Moisetë. E kotë të prisje, asnjëra nuk do ta kallëzonte fajtoreshën. Sa herë futej papritur autoriteti në hapësirën e tyre, forcohej më tepër bashkëpunimi i tyre. Si rrjedhojë, dënimet ose zhdukeshin, ose jepeshin dyshe. Pak rëndësi kishte për to, nëse nuk u jepnin ëmbëlsirën, nëse mësuesja u caktonte shumë orë studim, nëse nuk i ftonte shoku që kishte dalë nga binarët pas vizitës së tyre, çifti që ato formonin kishte më shumë rëndësi se zemërimi, apo hakmarrja e të huajve. Ato krijonin një bllok të vetëm.

Por ama, larg vështirësive, blloku plasaritej. Nëse fizikisht dallimi ishte vetëm një kilogram - forma e rumbullakët e Lilit - psikologjikisht plasaritjet thelloheshin.

Lili u dilte përpara situatave. Ambasadore e binjakëve, e guximshme, ndihej rehat në vendin e ndriçueses, ajo përgatiste takimet, lojërat, udhëtimet. Meqë ajo u drejtohej njerëzve, ata lidheshin fillimisht me të. Duke qenë se pozicioni i saj vetvetiu prej drejtueseje u bë i zakonshëm, më tepër dëgjohej të flitej për “Lilin”, ose për “binjaket”, sesa për “Moisetën”, disa mjaftoheshin duke thënë “tjetra”, shumica e harronin emrin e saj.

Pa i shkuar mendja të kundërshtonte këtë rend pothuaj të natyrshëm, Moisetë ndiqte motrën e madhe, por dallonte hijen që ajo i bënte. Për dy vjet me radhë, ajo nuk i mbajti kurrë mëri së motrës, motrës së saj të nevojshme, motrës së saj të përjetshme, motrës larg së cilës ajo do të ndihej

e paplotë; ajo qortonte më tepër të rriturit e shpenguar, indiferentë, pa kujtesë. Madje Lili i shkonte shumë mbas fillit Moisetës kur kjo e fundit ankohej për mungesën e vëmendjes nga filani, apo fisteku, dhe i dilte gjithmonë në mbrojtje.

Meqë për Krishtlindje apo ditëlindje ato merrnin tashmë dhurata të ndryshme, kishin vendosur një strategji: shtireshin si të lumtura në publik, por sapo ishin vetëm, i shkëmbenin. Moisetë, sistematikisht e zhgënjyer nga të sajat, kërkonte të shtinte në dorë të Lilit, e cila ia jepte pa ngurrar, madje as nuk mërzhitej kur Moisetë nuk ia jepte të sajat.

Rreth moshës shtatëvjeçare shkolla fillore plasariti lidhjen e tyre. Moisetë, më e ngadaltë, më pak e saktë se e motra, mezi mësonte. Mësuesit i njoftuan prindërit. Nga ai takim, Moisetë u nxi nga inati: ritmi i saj i të mësuarit, njëlloj me një të tretën e klasës, jo më i keq se ai i shokëve tyre, nuk do të kishte tërhequr vëmendjen e askujt, sikur të mos kishte në krah një motër të shkëlqyer. Nga nxënëse normale, ajo bëhej mediokre, sepse e krahasonin me Lilin! Ajo i mbajti inat që u bë shkaku i këtij krahasimi, e mallkoi në heshtje që ishte më e zonja dhe e bëri rrugë t'ia hidhte fajin Lilit kur merrte notë të keqe.

Rreth moshës dhjetëvjeçare ndodhi hataja: një mësuese propozoi të ndaheshin binjaket dhe të vendoseshin secila në një klasë të nivelit të saj. Më kot mësuesja mburri meritat e diferencës, premtoi një zhvillim më të mirë, i këndoi eficiencës së formulës individuale, Moisetë uli kokën dhe vështroi Lilin me neveri.

Nga ai moment, ajo shkatërroi rregullisht dhomën e së madhes, prishte librat, thyente lapsat, shkatërronte vizatimet, bënte vrima në rroba. Por Lili i rregullonte, i riparonte pa thënë një fjalë, duke mbrojtur motrën e vogël. Nuk i shkonte në mend ta kritikonte, e bindur se kishin pak konsideratë për Moisetën.

E qetë, e arsyeshme, Lili nuk lejonte të zbuloheshin ligësitë e të motrës. Kur e pësonte shumë nga agresiviteti i saj, ajo tregonte një gjakftohtësi të zgjuar. Kështu, ditën e kungimit, ngaqë i kishte për zemër gjërat që kishte kërkuar, shkoi herët në tryezën ku ishin vendosur dhuratat, ndërroi emrat, dhe kështu ajo mundi të merrte ato që kishte dëshiruar, po atë mbrëmje, në qetësinë e natës, kur Moisetë ndërroi dhuratat e tyre.

Gjatë vitit të dymbëdhjetë, ekuilibri i tyre ndryshoi.

Një mëngjes, Moisetë vështroi ngultas Lilin dhe deklaroi:

- Dukesh për ibret.

Gojëhapur nga habia, Lili e pa nga koka te këmbët.

- Edhe ti.

Dolën të dyja para pasqyrës, konstatuan se reflekset u jepnin të drejtë: fytyrat e tyre po ndryshonin.

Një javë më pas, Moisetë ndali vështrimin në ijët e Lilit.

- Mjaft hëngre: po shëndoshesh aq shumë sa do të shpërthejnë tegelat e fundit.

- Edhe ti.

Edhe këtë herë, pasqyra u pohoi katastrofën e përbashkët. Si ushtri e fshehtë, hormonet kishin pushtuar mishin e tyre dhe po e shndërronin.

Nuk kishte mëngjes kur njëra të mos vërente te tjetra ndonjë të metë, që e gjente sakaq te vetja, një puçërr mbi hundë, gjinj që fryhen, qime që mbijnë, dhjamë në kofshë, lëkura që lyroset, një aromë tjetër... Ato kishin lënë pas brigjet e fëmijërisë për të prekur kontinentin e grave, por për momentin lundronin në ujërat e të pahijshmes.

Lili zbulonte e shastisur trupin e saj të ri te binjakja e saj. Kurse Moisetë nuk duronte dot spektaklin e këtij tmerri që i shfaqte e motra. A qëndrojmë dot njëzet e katër orë para pasqyrës? Në sytë e saj, e shpifura Lili i kujtonte vazhdimisht shëmtinë e saj; shkurt, Lili e bezdiste aq shumë duke shfaqur të metat e saj, saqë ajo e urrente.

Falë mrekullisë, sapo estrogjenët e kryen kolonizimin dhe përmbyllën metamorfozën, motrat Barbarin na dolën shumë të bukura. Që të dyja njëlloj të bukura.

Moiseta rrëzëllente.

Lamtumirë pabarazisë që ishte shfaqur gjatë shkollimit, ato ishin përsëri identike!

Paradoksalisht, flirtet e para i afruan. Të trembura nga dëshirat e tyre, të etura të ushtronin pushtetin e ri mbi djemtë, të pasionuara pas lojërave të joshjes, ato këshilloheshin vazhdimisht me njëra-tjetrën dhe krijuan një lidhje të fortë, që i ngjante më tepër solidaritetit të ushtarëve para një rreziku të paparë se një miqësie të vërtetë. Ato tregonin

përpjekjet, dështimet, sukseset e tyre, kështu që Moisetë, më pak e hedhur se Lili, përfitonte nga gabimet e së madhes, për t'iu futur dhe ajo aventurës me më shumë mprehtësi dhe e pëlqenin më shumë.

Ndonjëherë deheshin nga kënaqësia duke u tallur me djemtë, teksa zinin vendin e tjetrës për një puthje të beftë, apo një llafosje romantike. Në moshën ku adoleshentet i druhen pushtetit të meshkujve, ato mburreshin, krenare, se kishin ngadhënjyer me pamjen e jashtme, se i zotëronin djemtë që u vinin rrotull.

Po njëra-tjetrën e donin? Në mënyrë të padiskutueshme, Lili e adhuronte të motrën, shqetësohej për lumturinë e saj, lumturohej kur ajo lumturohej, trishtohej kur ajo trishtohej. Moisetë kishte po aq rëndësi sa ajo, në mos më shumë. Afërsisë mishore, që ekzistonte prej lindjes, Lilit i kishte shtuar tashmë një dashuri të thellë, thelbësore.

Për Moisetën ishte më tepër çështje zakoni sesa dashurie. Ndonëse ajo ndiente një nevojë pothuaj fizike për Lilin, nuk vdiste nga hidhërimi kur kjo e fundit ishte keq, nuk merrte kurrë iniciativën për të ose për dyshen e tyre, nuk e përfshinte të madhen në ëndrrat e saj për të ardhmen, madje mund të gëzohej kur e shihte në vështirësi.

- Njihu me Fabienin.

Një pasdite të nxehtë si furrë, Lili i tregoi me dorë Moisetës një djalosh brun, me sy të zjarrtë, kraharor të

fryrë, bel të harkuar, këmbët të formuara sikur sa kishte zbritur nga kali.

Që kur e kishte njohur te një shoqe para një jave, Lili i fliste për Fabienin dhe nuk ia kishte fshehur që ndiente dashuri, për herë të parë.

E paduruar, e ngazëllyer nga shfaqja e “dashurisë” në jetën e tyre, Moisetë e kuptoi rrëmbimin e Lilit duke zhbiruar Fabienin shtatlartë, trupdredhur, qëndrim elegant, i ndërthurur me çapkënin, flokët kaçurrelë pak si shumë të gjatë, iridë e gjelbër e shpuar nga një bebëz e errët, që e bënë të dukej i hipnotizuar nga vajzat. I lidhur mirë, mes dhëndrit ideal dhe maskarait, ai kishte buzë mishtore, që vizatonin një buzëqeshje mizore dhe të gëzuar.

Moisetë u skuq nën vështrimin e tij, një vështrim i shastisur prej ngjashmërisë së përsosur të motrave, një vështrim plot dëshirë... Me sa dukej, binjaket Barbarini bënë pjesë në shijet e këtij djali. Moisetë uli menjëherë qepallat. “Rrezik!”, ulëriu një zë i brendshëm. Zemra e saj rrihte fort, grushtet u shtrënguan, djersa i njomi sqetullat dhe pati frikë se mos gjaku i saj i tensionuar do t’i shponte venat e qafës.

Gjatë pasdites që e kaluan të tre bashkë, Moisetë e la Lilin të vendoste për argëtimet, për shëtitjet, për orën e çajit, për tipin e çajit, për biskotat që do të hanin me çajin, për vendin në kopsht ku do të pinin çajin... E kthyer në tërheqjen dhe ndrojtjen e fëmijërisë, ajo u mbyll, qeshte vetëm pas të motrës, hapte gojën vetën për të pohuar. E

turbulluar nga ai djalë, ajo mendonte ngadalë dhe ndiente një mpirje të ëmbël. Kjo situatë e bezdiste. E vetëdijshme që e motra po ndizej gjithnjë e më shumë, po pësonte dhe ajo rritje nxehtësie: nga njëra anë, ajo e miratonte entuziazmin e Lilit; nga ana tjetër, qortonte veten që e ndiente. Kështu, e shkatërruar nga tensioni, ajo psherëtiu e lehtësuar kur Fabieni, më në fund, u largua.

- Pra, çfarë mendon? - pyeti me ankth Lili.

- Si ti! - u përgjigj Moiseta.

- I pëlqej, apo jo?

Moiseta kujtoi si i ndrisnin sytë Fabienit kur vështronte Lilin.

- Sigurisht!

Lili u çmend nga gëzimi duke ardhur rrotull. Moiseta harroi të përmendte se kishte vënë re të njëjtin ngazëllim të Fabienit edhe ndaj saj.

Sapo Lili përfundoi vallëzimin e saj rreth tryezës, Moiseta kroj pak kokën.

- Mos është diçka fizike, mes teje dhe atij?

- Jo vetëm.

- Filloi me një shikim.

- Sigurisht. Nuk e njoha me korrespondencë...

- As në telefon...

- As në telefon! Po, ti ke të drejtë Moiseta: vështrimi i parë na elektrizoi. Një shkarkesë. Treqind volt. Jo, një mijë. Një goditje rrufeje.

- Pra, është diçka fizike kryesisht.

- Jo, Moisetë, është fizike së pari. Pastaj janë gjithë të tjerat... Eh po, gjithë të tjerat...

Ëndërrimtare, Lili e shqiptoi shumë herë “gjithë të tjerat” me ton misterioz.

Moiseta tundi kokën: ajo nuk po e kuptonte... “gjithë të tjerat”. Për dy orë biseda kishte pasur vetëm tema bajate, fjalë të stërpërdorura, shaka të rëndomta, heshtje të sikletshme të ndërprera nga të qeshura të stisura; ajo e kishte vënë re mirë këtë, për më tepër që nuk kishte marrë pjesë në bisedë, por kishte qenë e pranishme. Për interesat e tij, Fabieni shfaqej një djalë i rëndomtë, brutal, jo i kulturuar, i ngjashëm me mijëra të tjerë. Edhe pse dukej joshës, mendja e tij funksiononte më ngadalë se sytë e tij prej gjahtari.

Duke i ruajtur këto vlerësime për veten e saj, Moisetë u gëzua për kthjelltësinë e saj, e cila - pa dyshim - kapërcente atë të motrës së gjorë, të dashuruar.

Fabieni banonte gjatë dy muajve të pushimeve shkollore jo larg, në Amberië. I lirë mjaft, ai udhëtonte ku të donte me një motoçikletë që ia kishte lënë kumbari tij; Fabieni u abonua te Barbarinët.

Temperatura u rrit shpejt mes Lilit dhe Fabienit, po aq sa mercuri i barometrave asaj vere të zjarrtë. Në fund të korrikut, Lili i tha Moisetës se ajo nuk do të priste më: shumë shpejt do të bënte dashuri me Fabienin.

- Pa u martuar?

- Po!

- As fejuar?

- As dua t'ia di.

- Si the?

- Më kupto drejt, Moiseta. Sigurisht, unë dua të kaloj gjithë jetën me Fabienin, sepse e dua. Por si të sigurohem se kjo do të ndodhë? “Gjithë jetën”... Abstrakte, apo jo? E pastaj, ai është këtu vetëm këtë verë; do të kthehet në shtator në Lion. Jeta ime është tani, jo nesër. Pastaj, mjaft bëre si e habitur, ne e kemi diskutuar njëqind herë, ti dhe unë jemi kundër martesës. Nëse ndodh, aq më mirë. Nëse nuk ndodh, të paktën të kem fjetur me Fabienin.

Moiseta protestoi gjatë, me vrull, për orë, për ditë me radhë. Sigurisht, ndryshe nga brezat para tyre, ato kërkonin lirinë për të qenë femër para se të ishin bashkëshorte, por një forcë kokëfortë e bënte t'i kundërvihet Lilit duke gjetur sa më shumë argumente për ta frenuar. Cila forcë? Një frikë me një mijë fytyra, frika se mos humbte të motrën, frika se mos katandiste në pozicionin e së dytës, “tjetrës”, binjakja, e vogla, e vonuara, e ngadalta... Shushka, pra! Duke e penguar Lilin të fluturonte në krahët e Fabienit, ajo luftonte për veten, jo për Lilin.

Në mes të gushtit ajo u qetësua sepse Lili nuk fliste më për t'iu dhënë Fabienit, ndërronte bisedë sa herë që e motra prekte këtë temë. Moiseta ngadhënjeu. Ajo kishte ndaluar Lilin të rritej. Më mirë të qëndronin dy larva në këtë shtëpi, sesa një fshikëz dhe një flutur.

Mbrëmjen e 15 gushtit, pas festimeve tradicionale të Virgjëreshës ku ishin bërë tapë të gjithë, Moiseta dëgjoi pëshpërima poshtë shtëpisë që ishte në gjumë.

Mesnata sapo kishte trokitur nga kambana.

E shqetësuar, ajo doli nga krevati dhe iu afrua dritares pa zhurmë. Në rrugë, nën një hënë të kuqe, Lili këmbëzbathur, me sandalet në dorë, po takohej me një djalë me xhup mbi një motoçikletë. Pasi shaloi sediljen, ajo ngjeshi gjoksin e saj, u ngjit pas shpinës së tij, e gatshme tashmë, dhe Fabieni, duke goditur kalldrëmin me këmbë, shfrytëzoi tatëpjetën dhe peshën e mjetit për të ecur pa ndezur motorin deri te rruga kryesore që përshkonte fshatin. Çifti rrëshqiti pa zhurmë në cep të rrugës; pas disa sekondash u dëgjua gërhitja e cilindrave, zhurmë që u shtua për pak çaste pastaj u zhduk në largësi...

Heshtja pllakosi përsëri mbi peizazhin e shuar.

Moiseta fërgëlloi. Nuk ishte ndier kurrë kaq e vetmuar...

Ku shkonin ata? Ajo nuk e dinte. Por ama e merrte me mend atë që do të bënin... Nga çatia përballë ia kishte ngulur sytë fosforeshentë një maçok. Moiseta kafshonte grushtin nga inati. E motra kishte heshtur kohët e fundit ngaqë e kishte marrë vendimin. Lili ishte tallur dyfish me të: nuk ia vinte veshin dhe kishte zbuluar dashurinë para saj.

- E urrej! Nuk e kam urreyer kurrë kaq shumë.

Ajo përfytyronte të motrën në trupin e zhveshur të Fabienit, i cili lëvizte duke harkuar veshkat dhe duke ngritur vithet.

- Dosë! Ja ç'është, dosë, asgjë tjetër!

Në këto fjalë të pëshpëritura në buzët e saj, maçoku u ngrit, mosbesues, tendosi bishtin.

Moiseta u zmbraps në gjysmerrësirën e dhomës së saj dhe vuri re siluetën e saj qesharake në pasqyrën e madhe të dollapit: një karkalec me pizhame.

- Kuçkë! - i tha prapë së motrës.

I fyer, maçoku ia mbathi mbi tjegulla.

Atë mëngjes, si edhe më pas, Moiseta mbeti pa fjalë para ndryshimit të së motrës. Madhështore si ag, Lili shkëlqente, perandorake, solemne, aq e shndritshme sa të impononte respekt. Ngjyra e fytyrës e ullinjtë, flokët shkëlqim nga gjallëria, goja luleshtrydhe, sytë xixa. Lili, që kishte qenë një vajzë tepër simpatike, ishte bërë një grua e bukur. Fytyrën të përndezur nga një buzëqeshje e vazhdueshme, ajo dyfishonte efektin e gjesteve të saj: ajo nuk ecte më, por hidhej; kur nuk lëvizte, shndërrohej në sfinks; dhe kur shtrihej në divan, lëshonte një sensualitet përvëlues, si Afërdita duke pozuar për një skulptor të padukshëm. Kishte diçka që e rëndonte paksa, duke e bërë më ndjellëse, më të hijshme, më fatale. Sekreti i sensualitetit ndoshta?

Moiseta pushoi së kritikuari, aq shumë zili e kishte. Ajo donte vetëm t'i ngjante asaj përsëri. Kështu që u tregua shumë e dashur për t'i rregulluar prapë marrëdhëniet.

Duke u treguar e mirë, duke lënë të kuptohej se ishte në dijeni të asaj që ndodhte çdo natë, ajo mbetej sidoqoftë e besuara e saj besnike, ajo fitoi besimin e Lilit, e etur për t'u rrëfyer. Kjo e fundit përshkroi hambarin ku e çonte

Fabieni, dritën e yjeve mbi fytyrat e tyre, drithërimat në lëkurë kur ai e zhvishte, pushtetin seksual që ajo pikaste në sytë e mashkullit të zjarhtë, në ekstazë, fuqinë e saj erotike që shkaktonte po aq durim sa edhe padurim te Fabieni, po aq delikatesë sa edhe rrëmbim. Pastaj, e nxitur nga Moisetja, ajo foli me hollësi për gjërat që bënëin, çfarë i bënte ai, çfarë i bënte ajo, çfarë i pëlqente gjithnjë e më shumë, për çfarë çmendej ajo, çfarë do të provonte së shpejti... Ajo foli për frikën që të paralizon në fillim, që të jep guxim më pas. Ajo përshkroi rrugën e turpfit, neverinë që kishin ndier që në fillim kur mendonin disa lloje prekjesh, një neveri që shkrihej gjatë dashurisë, neveri që shndërrohej në të kundërtën e saj, dëshirimin, pra ajo neveri që ishte karakteristikë e vajzave të vogla.

E magjepsur nga këto rrëfime, edhe Moisetja ndihej grua, duke rigjetur pothuaj pandashmërinë e viteve të para. Megjithatë, natën, kur Lili ia mbathte nga shtëpia në motorin e Fabienit, Moisetja, e vetme në shtratin e saj, e urrente përsëri, e lënë pas dore, e mohuar, e inatosur që i kishte mbetur vetëm të fantazonte.

Më 31 gusht, një ngjarje dramatike tronditi jetën e Barbarinëve. Gjatë darkës, një kushëri trokiti në derë për të njoftuar se gjyshja Garsën po shuhej dhe kërkonte të bijën.

Zonja Barbarin, në panik, vendosi t'i shkojë menjëherë pranë, në Montalië, 15 kilometra në jug. Zoti Barbarin u turr të nxjerrë makinën nga garazhi për të çuar të shoqen.

“Citroën”-i qëndronte para shkallëve, me motor të ndezur. E shoqëruar nga binjaket, zonja Barbarin kapërceu pragun pastaj u kthye papritur nga Lili.

- Eja me mua.

Lili u zmbraps në korridor.

- Unë?

- Po.

Ndonëse e hidhëruar nga ajo që i kishte ngjarë të gjyshes, Lili mendonte për Fabienin që e priste atë natë si gjithë të tjerat. I hodhi një vështrim të dëshpëruar Moisetës. Përsëriti:

- Unë?

- Nxito! Jepi! Vish këpucët.

- Je e sigurt? - belbëzoi Lili.

- Po, eja të rrish pranë gjyshes tënde.

- Pse unë dhe jo Moisetë?

E acaruar, e tensionuar, nëna nuk e kishte mendjen të kujdesej për formulimin e fjalëve, duke hyrë në makinë dhe ia ktheu:

- Sepse jot gjyshe të donte shumë!

Vajzat u drodhën. Moisetë mbështeti kurrizin në murin e korridorit - do të kishte rënë sikur të mos e kishte mbajtur muri. Çfarë? Gjyshja e saj e dashur nuk e donte? Preferonte Lilin? Edhe ajo?

Lili e ndjeu goditjen që iu dha së motrës dhe e vështroi gjithë mëshirë. Nëna e kapi atë vështrim, e kuptoi gafën, por në vend që të kërkonte falje, u nxeh më tepër:

- Ah, dreqi e mori, mjaft! Mos i komplikoni gjërat ju

të dyja. Jo sonte. Lili, më ndiq. Moisetë, ruaj shtëpinë. Shihemi nesër!

Ajo përplasi derën. Lili pati njëzet sekonda për të hipur në ndenjësën e pasme. Vetura u nis me tërbim. Moisetë qëndroi një kohë të gjatë në kuadratin e derës. Vetëm... Edhe këtë herë... Vetëm... Mënjatë dramave familjare... Mënjatë dashurisë familjare... Vetëm... Ajo duhet të ruante shtëpinë... Si një qen... Vetëm...

Vendimin e mori në mënyrë të pavetëdijshme. U ngjiti në dhomën e Lilit, u mbyll në banjë, u la, u përgatiti, u spërkat me parafumin e saj dhe veshi një nga fustanet e saj.

Rreth mesnatës, kur u shfaq Fabieni, Moisetë bënte ecejake para derës së fqinjëve, sikurse do të kishte vepruar Lili.

Ajo shaloi sediljen, shtrëngoi Fabienin pas vetes, u ngjesh pas shpinës të tij dhe e la veten të lirë...

Dy orë më pas, ishte bërë grua në krahët e burrit. Nuk i kishte dalluar të gjitha ato që i kishte treguar e motra, por një pjesë po. Në fillim, ishte treguar e zellshme, pak si tepër madje për të përfutur, pastaj, në përfaqimet e fundit, kishte lëshuar fill më në fund dhe kishte ndier emocione të fuqishme.

Tani ata po pushonin lakuriq, në kurriz, pranë njëritjetrit, duke vështruar hënë që po shfaqej pas kamares së çatisë. Atë mbrëmje qielli kishte më tepër yje se zakonisht.

Ata heshtnin të dy, të rraskapitur, duke u përpjekur të rregullonin frymëmarrjen.

Së pari e lumtur, pastaj ndërsa trupi i saj qetësohej dhe zemra ngadalësohej, Moiseta druante se e priste më e vështira: biseda. Deri atëherë ata kishin shkëmbyer vetëm disa gjysma fjalësh në fshat, kishin udhëtuar gjatë natës, pastaj ishin hedhur menjëherë njëri mbi tjetrin në mes të rrogosit të sajuar në dengjet me sanë.

A do ta tradhtonte ajo veten duke biseduar? Papritmas pati frikë nga kjo.

Fabieni u kthye nga ajo, u mbështet në bërryl, i ledhatoi ijët ndërsa e shikonte.

E turpëruar, ajo buzëqeshi. Buzëqeshi edhe ai.

- Pra, Moiseta, të pëlqeu?

Ajo ngriu, hezitoi, pastaj gjeti forcën për të sajuar një të qeshur që nuk do të dukej false.

- Ha-ha-ha... Pse po më quan Moiseta?

Uff, ajo kishte pasur sukses në intonacionet e saj: zëre se kishte qenë Lili që qeshte mbytur me një barsoletë të fortë. Ajo përsëriti prapë:

- Pse po më quan Moiseta?

- Sepse ti je Moiseta.

- Në këtë moment, Moiseta është duke fjetur në shtratin e saj, si çdo natë.

Buzëqeshja e Fabienit u zgjat, e mprehtë.

- Më merr për leshko?

Moiseta u drodh, por vazhdoi: